

20081302526

L I G J
PËR SHPALLJEN E ÇARSHISË SË VJETËR TË SHKUPIT TRASHËGIMI
KULTURORE ME RËNDËSI TË VEÇANTË

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Çarshia e Vjetër e Shkupit, e cila paraqet një tërësi monumentale, shpallet trashëgimi kulturore me rëndësi të veçantë, nënkategoria – rëndësi e madhe.

Me shpalljen e tërësisë monumentale “Çarshia e Vjetër të Shkupit” trashëgimi kulturore me rëndësi të veçantë mundësohet:

- ruajtja e përhershme e vlerave historike, artistike, arkitektonike, urbanistike, ambientale, etnologjike, sociologjike dhe vlerave të tjera shkencore e kulturore, si dhe autenticitetit, veçantisë, llojllojshmërisë, integritetit, vjetërsisë dhe cilësive, përmbajtjeve dhe funksioneve të tjera;

- krijimi i kushteve të volitshme për mbijetesën dhe ruajtjen e integritetit të të gjitha fakteve që i mban në vete si dëshmi;

- përhapja e njohurive për vlerat, rëndësinë dhe rolin e saj në identifikimin kulturor;

- aftësimi që të shërbejë për plotësimin e nevojave kulturore, shkencore, edukative, estetike, ekonomike, turistike dhe nevojave të tjera të qytetarëve, si dhe

- pengimi i veprimeve, dukurive dhe ndikimeve me të cilat bëhet ose mund të shkaktohet dëmtim apo degradim.

Tërësia monumentale “Çarshia e Vjetër e Shkupit” e krijuar në periudhën prej shek. XV deri në shek. XX mbi strukturën urbane që rrjedh nga shek. XI, trashëgimi kulturore me rëndësi të veçantë, është e mirë me interes të përgjithshëm për Republikën e Maqedonisë dhe gëzon mbrojtje të veçantë në pajtim me këtë ligj, Ligjin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe ligj tjetër.

Neni 2

Tërësia monumentale “Çarshia e Vjetër e Shkupit” (në tekstin e mëtejme: Çarshia e Vjetër e Shkupit) gjendet në rajonin e komunave Çair dhe Qendër, dhe përfshin hapësirën me koordinatat X: 21° 26' 15"-84" dhe X:42° 00' 08"-56", me sipërfaqe të përgjithshme prej 11 ha 58 ari dhe 14,71m².

Neni 3

Çarshia e Vjetër e Shkupit i ka kufijtë si vijojnë:

Lindje - fillon nga pika prerëse e boshtit në rrugën “Samarxhiska” dhe boshtit në rrugën “192” dhe shkon nëpër vijën e drejtë të vazhduar në jug nëpër boshtin e rrugës “192”, deri në prerjen e boshtit të rrugës “Bitpazarska” (PK 13758). Kufiri i tërësisë monumentale në këtë drejtim shkon në jug, duke i përfshirë objektet që e formojnë fasadën e rrugës nga ana lindore e rrugës “Bitpazarska”, sipas radhitjes si vijon: nëpër anën lindore të rrugës “Bitpazarska” PK 13785, deri në lidhjen me kufirin verior të PK 7596, vazhdon nëpër PK numër 7596 (në anën veriore dhe lindore të PK), 7597 (në anën lindore të PK), 7605 (në anën veriore, lindore dhe jugore të PK), 7601 (në anën lindore të PK), 7602 (në anën lindore të PK), 7603 (në anën lindore të PK), 8999 (në anën veriore, lindore dhe jugore të PK), 9000 (në anën lindore të PK), 9002 (në anën lindore të PK), 9003 (në anën lindore të PK), 9006 (në anën veriore dhe lindore të PK), 9007 (në anën lindore të PK), 9008 (në anën lindore të PK), 9009 (në anën lindore të PK), 9012 (në anën lindore të PK), 9014 (nëpër anën veriore, lindore dhe jugore të PK), e pret rrugën “113”

(PK 8992) dhe vazhdon nëpër 8991 (në anën lindore të PK) deri në prerjen me boshtin në rrugën “191” (PK 8967), shkon në lindje deri në prerjen me kufirin lindor të PK 8955 dhe vazhdon nëpër 8955 (në anën lindore dhe jugore të PK), 8959 (në anën lindore dhe jugore të PK), e pret rrugën “190” (PK 8943) dhe vazhdon nëpër PK 8891/6 (në anën lindore dhe jugore të PK). Kufiri vazhdon në anën lindore të rrugës “Bitpazarska” (ana lindore e PK 13758) në jug, duke i përjashtuar objektet e PK 8911, 8910, 8909, 8908, 8907, 8906, 8905/1, 8905/2 dhe 8901. Në vazhdim, kufiri shkon nëpër vijën ndërtimore të fasadës perëndimore të objektit, Shtëpia e mallrave “Ilinden” (PK 8901), përkatësisht nëpër kufirin lindor të PK 13785, dhe në jug vazhdon në vijë të drejtë deri në pikën e prerjes me kufirin jugor të PK 13785.

Jug – fillon nga pika e prerjes së kufirit lindor me kufirin jugor të PK 13758, vazhdon në perëndim nëpër kufirin jugor të PK 13758, shkon në mënyrë drejtvizore deri në kufirin jugor të PK 9486 (rruga “Teodosij Golloganov”), vazhdon nëpër kufirin jugor të PK 9503/2, ndërsa përfundon në drejtimin e njëjtë 13 metra në perëndim, nga pika e prerjes të kufirit jugor dhe verior të PK 9503/2.

Perëndim – fillon nga prerja e definuar 13 metra në perëndim nga pika e prerjes të kufirit jugor dhe perëndimor të PK 9503/2, në veri kufiri në këndin prej 90 shkallësh vazhdon nëpër PK 9493/1, deri në bashkimin me boshtin e rrugës “Samoilova” (PK 13678) deri në prerjen me boshtin e rrugës “Prohor Pçinski” (PK 13725), vazhdon nëpër boshtin e rrugës “Prohor Pçinski” (PK 13725) deri në prerjen me boshtin e rrugës “Josif Mihajloviq”,

Veri - fillon nga prerja e boshtit të rrugës “Prohor Pçinski” dhe boshtit të rrugës “Josif Mihajloviq”, shtrihet nëpër boshtin e rrugës “Josif Mihajloviq” deri në prerjen me rrugën “Dërvarska”, vazhdon nëpër boshtin e rrugës “Dërvarska” deri në prerjen me rrugën “Kovačka”, shkon nëpër boshtin e rrugës “Kovačka” deri në prerjen me rrugën “Samarxhiska” dhe shkon nëpër boshtin e saj deri në prerjen me rrugën “192”.

Neni 4

Çarshia e Vjetër e Shkupit ka tri zona kontakti, si vijojnë: zona e kontaktit “Mavrovka”, zona e kontaktit “Most” dhe zona e kontaktit “Duqanxhik”, me sipërfaqe të përgjithshme të atyre zonave prej 23 ha 46 ari 47,11 m².

Zona e kontaktit “Mavrovka” përfshin sipërfaqe të përgjithshme prej 7 ha 9 ari dhe 52,32 m² dhe i ka kufijtë si vijojnë:

Lindje – fillon nga prerja e rrugës “Bitpazarska” me bulevardin “Kërste Misirkov”, shkon nëpër boshtin e bulevardit “Kërste Misirkov” (PK13780) deri në prerjen me boshtin e bulevardit “Goce Dellçev”.

Jug – fillon nga pika e definuar me prerjen e boshtit të bulevardit “Kërste Misirkov” (PK 13780) me boshtin e bulevardit “Goce Dellçev”, shkon nëpër boshtin e bulevardit “Goce Dellçev” (PK 13787) deri në prerjen me vazhdimin nga kufiri verior i PK 8901;

Perëndim -fillon nga prerja e boshtit të bulevardit “Goce Dellçev” (PK 13787) me vazhdimin nga ana perëndimore të PK 8091, shkon në veri nëpër kufirin perëndimor të PK 8091, kalon nëpër kufirin perëndimor të PK 8905/1, 8906, 8907, 8908 , 8909 dhe 8910, vazhdon nëpër kufirin verior dhe perëndimor të PK 8891/1 (pjesë e rrugës së re të projektuar “Stiv Naumov”), e pret rrugën “190” (PK 8943) dhe shkon nëpër kufirin e saj verior në lindje, kthen në veri nëpër kufirin perëndimor të PK 8957, shkon nëpër kufirin verior të PK 8957 dhe PK 8955, vazhdon nëpër anën perëndimore të PK 8951, e pret rrugën “190” (PK 8943) dhe shkon nëpër kufirin jugor të PK 8989 dhe PK 8990, vazhdon nëpër kufirin jugor dhe perëndimor të PK 8986, e pret rrugën “113” (PK 8992), vazhdon nëpër kufirin perëndimor të PK 9005 dhe 9004, shkon nëpër kufirin perëndimor dhe verior të PK 8998/2, vazhdon nëpër kufirin perëndimor dhe jugor të PK 7606, nëpër kufirin verior dhe perëndimor të PK 7604, vazhdon nëpër kufirin verior të PK 7594 në lindje, deri në pikën e prerjes të boshtit në rrugën “Bitpazarska” (PK 13758) dhe boshtit në rrugën „192”, dhe

Veri – shtrihet nëpër boshtin e rrugës “Bitpazarska” (PK 13758), nga prerja me rrugën “192” deri në prerjen me bulevardin “Kërste Misirkov”.

Zona e kontaktit “Most” përfshin sipërfaqe të përgjithshme prej 6 ha 59 ari 3,52 m² dhe i ka kufijtë si vijojnë:

Lindje - fillon nga pika e prerjes së kufirit perëndimor të PK 8901 me kufirin verior të bulevardit “Goce Dellçev” (PK 13787), në mënyrë ortogonale vazhdon në jug deri në prerjen me kufirin lindor të PK 9509 (e cila përputhet me vijën ndërtimore të fasadës perëndimore të objektit të TKM-së), vazhdon nëpër kufirin lindor të PK 9509 deri në prerjen me kufirin e saj jugor.

Jug dhe perëndim - fillon nga pika e prerjes së kufirit lindor dhe kufirit jugor të PK 9509, vazhdon nëpër kufirin jugor të PK 9509 dhe boshtin e rrugës “Pitu Guli” (PK 9520) në perëndim deri në prerjen me boshtin e rrugës “Mareshali Tito” (PK 13829), nga ajo pikë vazhdon nëpër boshtin e rrugës “Ilo Vojvoda”, deri te prerja me boshtin e bulevardit “Goce Dellçev” (PK 13787).

Veri - fillon nga pika e prerjes së boshtit të rrugës “Ilo Vojvoda” dhe boshtit të bulevardit “Goce Dellçev” (PK 13787), shkon në lindje nëpër boshtin e bulevardit “Goce Dellçev” në gjatësi prej 240 m, për të vazhduar nëpër kufirin verior të bulevardit “Goce Dellçev” deri në pikën e prerjes me kufirin perëndimor të PK 8901.

Zona e kontaktit “Duqanxhik” përfshin sipërfaqe të përgjithshme prej 9 ha 77 ari 91,27 m² dhe i ka kufijtë si vijojnë:

Lindje - fillon nga prerja e boshtit në këndin e djathtë të udhëkryqit në bulevardin “Jugosllavia” me boshtin e bulevardit “Kërste Misirkov”, shtrihet në jug nëpër boshtin e bulevardit “Kërste Misirkov” deri te prerja me boshtin e rrugës “Bitpazarska”.

Jug - fillon nga prerja e boshtit të bulevardit “Kërste Misirkov” dhe boshtit të rrugës “Bitpazarska”, vazhdon në perëndim nëpër boshtin e rrugës “Bitpazarska” deri te prerja me boshtin e rrugës “192”, shkon nëpër boshtin e rrugës “192” deri te prerja me boshtin e rrugës “Samarxhiska”. Kufiri vazhdon nëpër boshtin e rrugës “Samarxhiska” deri te prerja me rrugën “Kovačka”, në mënyrë të vazhdueshme shkon nëpër boshtin e rrugës “Kovačka” deri te prerja me boshtin e rrugës “Dërvarska”, prej atje shkon nëpër boshtin e rrugës “Dërvarska”, deri te prerja me boshtin e rrugës “Josif Mihajloviq”, vazhdon nëpër boshtin e rrugës “Josif Mihajloviq” deri te prerja me boshtin e rrugës “Prohor Pçinski”, shkon nëpër boshtin e rrugës “Prohor Pçinski” shkon deri te prerja me boshtin e rrugës “Samoilova”.

Perëndim - fillon nga prerja e boshtit në rrugën “Prohor Pçinski” me boshtin e rrugës “Samoilova” shtrihet nëpër boshtin e rrugës “Samoilova” deri te prerja me boshtin e rrugës “Lubotenska”, dhe

Veri – fillon nga prerja e boshtit të rrugës “Samoilova” me boshtin e rrugës “Lubotenska”, shkon në lindje nëpër boshtin e rrugës “Lubotenska”, i pret rrugët “Joakim Kërçovski “ dhe “Sllavej Pllanina” deri në prerjen me kufirin verior të PK 5848 dhe 5847, vazhdon nëpër kufirin verior të PK 5848 dhe 5847 deri te prerja me boshtin e rrugës “Prohor Pçinski”, vazhdon nëpër boshtin e rrugës “Prohor Pçinski” deri në prerjen me boshtin e rrugës “Dërvarska”, vazhdon nëpër boshtin e rrugës “Dërvarska”, e pret rrugën “Albert Staniq”, vazhdon nëpër kufirin verior të rrugës “Dërvarska” (PK 13754) deri në bashkimin me kufirin verior të PK 6172. Prej atje shkon në lindje nëpër kufirin verior të PK 6172 dhe PK 6186 (Teatri i Kombësive) deri në pikën e prerjes me boshtin e rrugës “192”, , vazhdon nëpër boshtin e rrugës “192”, deri në prerjen me boshtin e rrugës “124”, shkon nëpër boshtin e rrugës “124” deri te prerja me boshtin në këndin e djathtë të udhëkryqit në bulevardin “Jugosllavia” dhe vazhdon deri te prerja me boshtin e bulevardit “Kërste Misirkov”.

Çarshia e Vjetër e Shkupit në anën perëndimore kufizohet me të mirën e mbrojtur “Kalaja e Shkupit” dhe nuk ka zonë kontakti në atë anë.

Neni 5

Kufijtë e Çarshisë së Vjetër të Shkupit dhe të zonave të saj të kontaktit, sipas neneve 3 dhe 4 të këtij ligji (në tekstin e mëtejshëm: rajon i mbrojtur), Agjencia e Kadastrës së Patundshmërive i paraqet në bazën gjeodezike me përpjesëtim 1:1000.

Organi nga paragrafi 1 i këtij neni, për secilën parcelë kadastrale që gjendet në kufijtë e rajonit të mbrojtur, në evidencën dhe dokumentacionin kadastral shënon se është pjesë përbërëse e Çarshisë së Vjetër të Shkupit, si trashëgimi kulturore me rëndësi të veçantë, e për secilën të mirë të veçantë të mbrojtur në kufijtë e rajonit të mbrojtur, dhe se e ka statusin e trashëgimisë kulturore të kategorisë përkatëse, të përcaktuar me aktin e shpalljes së saj.

Kufijtë e rajonit të mbrojtur nga paragrafi 1 i këtij neni, nuk mund të ndryshohen me planin hapësinor dhe urbanistik, e as me akt të llojit tjetër, përveç me aktin për mbrojtje ose aktin për ndryshim, në pajtim me dispozitat për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

Neni 6

Për shkak të mbrojtjes, rregullimit, rivitalizimit dhe shfrytëzimit racional të Çarshisë së Vjetër të Shkupit dhe të zonave të kontaktit të saj, komunat Çair dhe Qendër miratojnë plane të hollësishme urbanistike për rajonet nga kompetenca e tyre, që janë në kuadër të rajonit të mbrojtur.

Planet nga paragrafi 1 i këtij neni përpilohen sipas bazave mbrojtëse-konservuese, të përgatitura nga Institucioni Nacional – Qendra Konservuese Shkup.

Bazat e miratuara mbrojtëse-konservuese nga paragrafi 2 i këtij neni, inkorporohen në planet urbanistike në pajtim me dispozitat për planifikim urbanistik, mbrojtje të trashëgimisë kulturore dhe me këtë ligji.

Planet nga paragrafi 1 i këtij neni nevojitet të harmonizohen me Programin nga neni 11 i këtij ligji.

Neni 7

Në Çarshinë e Vjetër të Shkupit nuk guxon:

1) të ndryshohet struktura ekzistuese urbane, përkatësisht rrjeti i rrugëve, madhësia e blloqeve dhe parcelave, lokalet e hapura dhe ngjashëm;

2) të ndërtohen apo inkorporohen kapacitete industriale dhe të ngjashme, që kontribuojnë për praninë e formave të ndryshme të ndotjes;

3) të ngrihen përmendore përkujtimore dhe shënime përkujtimore, që nuk lidhen me krijimin dhe zhvillimin e Çarshisë së Vjetër të Shkupit; dhe

4) të bëhet gërmimi i themeleve apo bodrumeve, e as të bëhen kurrfarë lloji tjetër i punëve tokësore apo ndërtimore pa zbatimin paraprak të hulumtimeve arkeologjike mbrojtëse;

Mbrojtja e drejtpërdrejtë e Çarshisë së Vjetër të Shkupit zbatohet sipas parametrave të hollësishme për mbrojtjen e rajonit të mbrojtur, të përcaktuara me planet e hollësishme urbanistike të nenit 6 të këtij ligji, si dhe sipas kushteve të veçanta të përcaktuara mbrojtëse-konservuese, që kanë të bëjnë veçanërisht me:

1) ruajtjen e karakterit këmbësor të Çarshisë së Vjetër të Shkupit, me përjashtime në aspektin e regjimit të veçantë për furnizim dhe për automjete me dedikim special;

2) ruajtjen e lartësisë ekzistuese të objekteve, formës së çative dhe materialeve origjinale të çative, me përdorimin e obligueshëm të qeramidheve si material për mbulimin e çative të ndërtesat e reja;

3) harmonizimin e lartësisë, pamjes, ngjyrës dhe parametrave të tjera për objektet e reja të ndërtuara, përkatësisht objekteve që ndërtohen në lokacionet e zbrazëta ose në vendet e objekteve të vjetruara pa vlera, me ato të objekteve ekzistuese fqinje;

4) fshehjen e të gjitha llojeve të përçuesve të infrastrukturës dhe instalimeve, përkatësisht të sigurohet që ato të mos jenë të dukshme në sipërfaqen e Çarshisë së Vjetër të Shkupit dhe të fasadave në rrugë;

5) përdorimin e drurit cilësor për punimin e zdrukthëtarisë, në vend të metalit ose llamarinës së plastifikuar, dhe mënjanimin përkatësisht zëvendësimin gradual të profileve të përdorura metalike apo të plastifikuara në fasadat e rrugëve;

6) përjashtimin e mundësisë që të vendosen dhe mënjanohen mbështetësit tanimë të vendosur, antenave televizive, repetitorëve, panove të mëdha reklamuese e ngjashëm;

7) vendosjen e firmave dhe mbishkrimeve të tjera, panove, reklamave të neonit dhe llojit tjetër të reklamave, shenjave të komunikacionit, sinjalizimit të përmendoreve, ndriçimit, vendosjes së pllakave dhe pajisjes tjetër në rrugë dhe në lokale të tjera të hapura;

8) ruajtjen dhe mirëmbajtjen e funksioneve ekzistuese themelore të Çarshisë së Vjetër të Shkupit dhe kthimin e disa funksioneve tjera burimore ose shtimin e të rejave, funksioneve bashkëkohore në disa objekte, nëse funksionet e atilla janë në përputhje me natyrën e tyre dhe karakterin e tërësisë monumentale;

9) mbrojtjen e Çarshisë së Vjetër të Shkupit nga dëmtimet e çfarëdo lloji, veçanërisht nga ato që janë rezultat i shfrytëzimit joadekuat;

10) marrjen e masave preventive dhe korrigjuese kundër efekteve destruktive të zhurmës, goditjeve dhe vibracioneve të shkaktuara nga makinat dhe automjetet; dhe

11) kryerjen e punëve konservuese – restauruese dhe punëve të tjera të mbrojtjes së drejtpërdrejtë në bazë shkencore.

Neni 8

Në zonat e kontaktit të Çarshisë së Vjetër të Shkupit, nuk guxon:

1) të ndërtohen apo inkorporohen kapacitete industriale dhe të ngjashme, që kontribuojnë për praninë e formave të ndryshme të ndotjes;

2) të bëhet gërmimi i themeleve apo bodrumeve, e as të bëhet kurrfarë lloji tjetër i punëve tokësore apo ndërtimore, pa zbatimin paraprak të hulumtimeve arkeologjike mbrojtëse;

3) të ndryshohet rrjeti i rrugëve nëse me këtë prishet apo pamundësohet komunikimi funksional me Çarshinë e Vjetër të Shkupit;

4) në rrethinën e drejtpërdrejtë të Çarshisë së Vjetër të Shkupit të ndërtohen objekte lokacioni, gabariti dhe pamja e të cilave ndikojnë drejtpërdrejt në Çarshinë e Vjetër të Shkupit; dhe

5) të formësohen lokalet e hapura në mënyrë me të cilën do të degradohet ose shëmtohet autenticiteti i Çarshisë së Vjetër të Shkupit dhe rajonit të mbrojtur në tërësi.

Mbrojtja e drejtpërdrejtë në zonat e kontaktit zbatohet sipas parametrave të hollësishme për mbrojtjen e rajonit të mbrojtur, të përcaktuara me planet e hollësishme urbanistike të nenit 6 të këtij ligji, si dhe me ndërmarrjen e veprimeve që duhet të jenë në interes të sigurimit të kohezionit hapësinor të Çarshisë së Vjetër të Shkupit me rrethinën e saj të drejtpërdrejtë, me çka do të mundësohet zhvillimi i qëndrueshëm dhe ndërlidhja hapësinore e pjesëve të ndryshme për nga përmbajtja dhe vlera e rajonit të mbrojtur.

Neni 9

Komunat Çair dhe Qendër dhe organet e tyre, si dhe shërbimet publike, janë përgjegjëse për zbatimin e masave dhe të aktiviteteve në Çarshinë e Vjetër të Shkupit në kuadër të kompetencave të tyre të përcaktuara me këtë ligj dhe ligj tjetër.

Poseduesit e trashëgimisë kulturore në kuadër të Çarshisë së Vjetër të Shkupit, janë përgjegjës për mirëmbajtjen, ruajtjen, respektimin dhe shfrytëzimin e drejtë të trashëgimisë kulturore të Çarshisë së Vjetër të Shkupit.

Institucioni Nacional – Qendra e Konservimit - Shkup, është përgjegjëse për ndërmarrjen e masave mbrojtëse-konservuese në Çarshinë e Vjetër të Shkupit, në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

KËSHILLI NACIONAL PËR RIVITALIZIMIN E ÇARSHISË SË VJETËR TË SHKUPIT

Neni 10

Për realizimin e koordinuar të iniciativave, aksioneve apo projekteve të përbashkëta për mbrojtjen, rregullimin, shfrytëzimin dhe rivitalizimin e Çarshisë së Vjetër të Shkupit, Qeveria e Republikës së Maqedonisë formon Këshill Nacional për Rivitalizimin e Çarshisë së Vjetër të Shkupit, si trup koordinues dhe këshillëdhënës i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejme: Këshilli Nacional).

Këshillin Nacional përbëhet prej kryetarit dhe 10 anëtarëve, si vijon:

- 1) një përfaqësuesi nga radhët e personaliteteve të shquara nga sfera e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore dhe sferave të ngjashme,
- 2) një përfaqësuesi të Bashkësisë Fetare Islame,
- 3) një përfaqësuesi të Kishës Ortodokse Maqedonase,
- 4) dy përfaqësuesi të Komunës së Çairit,
- 5) një përfaqësuesi të Komunës Qendër,
- 6) një përfaqësuesi të Shoqatës së Zejtarëve - Çair,
- 7) një përfaqësuesi të Institucionit Nacional – Qendra Konservuese Nationale - Shkup,
- 8) një përfaqësuesi të Institucionit Nacional – Qendra Konservuese - Shkup,
- 9) një përfaqësuesi të Ndërmarrjes Publike për Lokale Banesore dhe Afariste e Republikës së Maqedonisë – Shkup, dhe
- 10) një përfaqësuesi të Drejtorisë për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore.

PROGRAMI PËR RIVITALIZIMIN E ÇARSHISË SË VJETËR TË SHKUPIT

Neni 11

Për shkak të aftësimit të Çarshisë së Vjetër të Shkupit, që të shërbejë për plotësimin e nevojave kulturore, shkencore, edukative, estetike, ekonomike, turistike dhe nevojave të tjera të qytetarëve, Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozimin e Këshillit Nacional, miraton Program për rivitalizimin e Çarshisë së Vjetër të Shkupit.

Programi nga paragrafi 1 i këtij neni miratohet për periudhën prej pesë vjetësh.

Programi përmban edhe planin e realizimit.

MBIKËQYRJA

Neni 12

Mbikëqyrjen ndaj zbatimit të këtij ligji e bën Ministria e Kulturës.

Mbikëqyrjen inspektuese ndaj zbatimit të këtij ligji, e bën Ministria përmes inspektorëve të kulturës, në pajtim me Ligjin për kulturë, dhe Drejtoria për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore, në pajtim me këtë ligj dhe me Ligjin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

Lidhur me zbatimin e dispozitave për ndërtim dhe planifikim hapësinor dhe urbanistik, mbikëqyrje dhe kontroll bëjnë organet kompetente për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit hapësinor.

DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 13

Planet e hollësishme urbanistike të nenit 6 të këtij ligji do të miratohen në afat prej tre muajsh nga dita e miratimit të Programit nga neni 11 i këtij ligji.

Neni 14

Qeveria e Republikës së Maqedonisë e themelon Këshillin Nacional në afat prej një muaji nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë e miraton Programin për rivitalizim nga neni 11 i këtij ligji në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji .

Neni 15

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.